

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

PER AKTIVITETIN “INSTALIM PER PRODHIM BETONI”

Me vendndodhje: Cerme e Siperme, Bashkia Divjake, Qarku Fier


Zhvillues: Subjekti “2S CONSTRUCTION” SHPK

Kerkues: Subjekti “2S CONSTRUCTION” SHPK

Adresa e selise: Fier Divjake CERME E SIPERME Rruga Terbuf , Pasuria
me 207/36 Zona Kadastrale 1381

NUIS: M54802401A

Adm: DAVID SULA



Hartoi Raportin e Permbledhjes Jo-Teknike
Ing. Ermelinda Agalliu

Tabela Përmbledhëse

1	HYRJE	3
1.1	Te pergjithshme.....	3
1.2	Qëllimi i Përmbledhjes Jo-Teknike.....	4
2	PERSHKRIMI I AKTIVITETIT	5
2.1	Qëllimi i Aktivitetit.....	5
2.2	Vendndodhja e Projektit.....	5
2.3	Infrastruktura e projektit.....	8
2.4	Prodhimi i Betonit.....	10
3	PERSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT	22
	Pozicioni Gjeografik dhe morfologjia	22
	Profili i Bashkisë Divjake.....	23
	Mjedisi Socio-Ekonomik.....	24
	Mjedisi Fizik.....	24
	Gjeomorfologjia dhe Gjeologjia.....	24
	Hidrogeologjia.....	24
	Sizmiteti.....	25
	Mjedisi Natyror.....	26
	Hidrografia.....	27
	Klima.....	28
	Tokat.....	29
	Ekologjia.....	29
	Mjedisi biologjik.....	29
	Flora dhe Fauna.....	29
4	IDENTIFIKIMI DHE MASAT ZBUTESE	30
	Identifikimi i ndikimeve të mundshme përgjatë fazës së funksionimit të impiantit.....	30
5	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	35
6	REKOMANDIME	36

<i>Figura 1</i>	<i>- Ortofoto e sipërfaqes së aktivitetit</i>	5
<i>Figura 2</i>	<i>– Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me njësinë administrative</i>	6
<i>Figura 4</i>	<i>– Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me zonat e banuara</i>	7
<i>Figura 5</i>	<i>– Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me hartën topografike</i>	7
<i>Figura 6</i>	<i>– Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me infrastrukturen rrugore</i>	9
<i>Figura 6</i>	<i>- Skica të projektit</i>	10
<i>Figura 7</i>	<i>– Harta administrative e Bashkisë Divjake</i>	24
<i>Figura 8</i>	<i>– Pozicionimi i pronës në hartë Gjeologjike</i>	27
<i>Figura 9</i>	<i>– Pozicionimi i pronës në Hartë Hidrologjike</i>	28

1 HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Subjekti “2S CONSTRUCTION” sh.p.k me administrator Z. David Sula, është regjistruar në QKB me NUIS, M54802401A për ushtrimin e veprimtarisë në fusha te ndryshme si me poshte:

“Nyje betoni , prodhim inertesh, tregtim me shumice dhe pakice te lendeve te ndryshme qe sherbejne ne ndertim si, hekur, çimento, llaç i pergatitur etj, punime germimi dhe shpimi me makineri te renda. Import eksport i makinerive te renda qe perdoren ne ndertim si dhe i materialeve te ndryshme. Investime, pjesmarrje ne fushen industriale, duke perfshire te gjitha operacionet komerciale, ndertimore, industriale se bashku me sherbimet perkatese qe konsistojne ne investimin, siper marrjen, realizimin, blerjen, shenderrimin, kompesimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndertimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, sherbimeve perkatese specifike ne konceptimin, krijimin, realizimin, tregtimin e mallrave te ndryshme me shumice dhe pakice, veprimtari ne fushen e shit - blerjes si dhe te gjithë formave te qirase apo shfrytezimit te pasurive te patundshme. Realizimin e kontratave marreveshjeve, ortakerive dhe shoqerive te perbashketa”.

Subjekti “2S CONSTRUCTION” sh.p.k do te ushtroje aktivitetin e tij në adresën: Fshati Cerme e Siperme, Njesia Administrative Terbuf, Bashkia Divjake per te cilin ka filluar me procedurat per pajisjen me Leje Mjedisore Tip B.

Te dhenat e prones sipas certifikates se rregjistrimit

- Pasuria nr. 207/17, pasuria nr. 207/36, dhe pasuria 207/38 zona kadastrale 1381, me siperfaqe totale 5492 m² ne pronesi te znj. Gurie Sula.

Shoqëria “2S CONSTRUCTION” sh.p.k nepermjet kontrates se qirase nenshkruar me pronarin e tokes znj. Gurie Sula, ka marre me qera pasurite nr. 207/17 pasuria nr. 207/36 dhe pasurine nr. 207/38 zona kadastrale 1381, me siperfaqe totale 5492 m², për ushtrimin e aktivitetit te prodhimit te betonit. (Kontrata e qerese bashkelidhur ketij raporti)

Shoqëria “2S CONSTRUCTION” sh.p.k është një subjekt i cili zhvillon aktivitetin e tij ekonomik te prodhimit te betonit në përputhje me legjislacionin në fuqi për prodhimin dhe tregtimin e materilave ndertimore.

Qëllimi i kompanisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave për beton me cilësi të larte dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e aktivitetit.

Aktiviteti ka për qëllim prodhimin e betonit për industrine e ndertimit.

Referuar ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR” aktiviteti “Instalim per prodhim betoni” klasifikohet per tu pajisur me Leje Mjedisore te tipit B.

Per kete arsye subjekti “2S CONSTRUCTION” po ndjek procedurat per tu pajisur me leje Mjedisore te tipit B per ushtrimin te aktivitetit; **Industria Minerare, Pika 3.1 e) Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj.).**

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi ka akses te shpejt ne rrugen dytesore dhe ndodhet edhe ne afersi te rruges kryesore qe lidh fshatrat

e Terbufit dhe Cerme e Siperme te cilat jane te asfaltura cka ndihmon ne mos perhapjen e pluhurave ne atmosfere. Gjithashtu pozicionimi ne afersi te rruges si edhe krijimi I rrugeve hyrese dhe dalese për ne impantet e prodhimit te betonit, krijon lehtesira për hyrje-daljen e automjeteve ne kete aktivitet.

1.2 Qëllimi i Përmbledhjes Jo-Teknike

Ky dokument përfaqëson një Përmbledhje Jo Teknike (PJT) të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetin “Instalim per prodhim betoni”, qe ushtrohet nga shoqëria “2S CONSTRUCTION” sh.p.k dhe shërben për informimin e palëve të interesit dhe publikut gjatë fushatë së organizimit dhe zhvillimit të Dëgjësës Publike per kete projekt.

Dokumenti paraqet në mënyrë të përmbledhur projektin, një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit fizik, biologjik dhe social në zonën e projektit, ndikimet kryesore në mjedis dhe ato sociale dhe detajon masat e planifikuara për të parandaluar, minimizuar, zbutur dhe shmangur këto ndikime.

Komunikimet dhe sqarimet për projektin gjatë procesit të informimit dhe Dëgjësës Publike mund të bëhen nëpërmjet postës elektronike:

Email: ronaldosina72@gmail.com ose në kontaktet e përcaktuara në njoftimin e publikuar në faqen elektronike të AKM-së për Dëgjësën Publike të këtij projekti.

2 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1 Qëllimi i Aktivitetit

Aktiviteti ka për qëllim prodhimin e betonit të markave të ndryshme me destinacion industrine e ndertimit (tregetim te betonit).



Figura 1 - Ortofoto e sipërfaqes së aktivitetit

Subjekti për prodhimin e betonit, do të sigurojë lëndën e parë të gatshme nga subjektet e licensuara që operojnë në vend dhe do ta magazinonjë atë në mënyrë të përkohëshme në sipërfaqen e aktivitetit. Cimentoja do të rruhet nëpërmjet sillosëve përkatës, të cilët sigurojnë mbrojtjen e produktit ndaj ndikimeve të kushteve atmosferike etj. Gjithashtu materiali inert do të hidhet në depozitat e agregateve ku nga aty nëpërmjet sistemit automatik të komandimit dergohet në hinkën e thithjes për dorezim në mikserin e betonit.

Impianti i prodhimit të betonit është një linjë e mbyllur dhe nuk gjeneron emetime apo ndikime në mjedis, duke përfshirë shkarkimet në ajër, tokë, ujë etj.

2.2 Vendndodhja e Projektit

Administrativisht zona e ku ushtrohet aktiviteti “Instalim për prodhim betoni”, bën pjesë në Njesinë Administrative Terbuf, Bashkia Divjake. Sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti “Instalim për prodhim betoni”, gjendet e pozicionuar në fshatin Cerme e sipërme, në afërsi të rrugës kryesore Terbuf- Cerme e Sipërme, Njesia Administrative Terbuf, Bashkia Divjake.

Pasuria nr. 207/17 dhe 207/36, Zona Kadestrale 1381 me sipërfaqe totale 4865 m². Siperfaqja ku ushtrohet aktiviteti i prodhimit të betonit ndodhet në pronësi private të znj. Gurie Sula e cila ka lidhur kontratë me Subjektin 2 S Construction për zhvillimin e këtij projekti.




Figura 2 – Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me njësinë administrative

Njesia Administrative Terbuf ku bëjnë pjesë edhe fshati Cerme e Siperme ndodhet në Bashkinë e Divjakës e cila shtrihet në Shqipërinë e Mesme dhe mbulon një sipërfaqe prej 309,58 km². Bashkia e re e Divjakës përbëhet nga pesë njësi administrative: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradishtë dhe Remas. Në vijim, Bashkia ka nën administrimin e saj qytetin e Divjakës dhe 39 fshatra, të cilat janë pjesë e rrethit të Lushnjës dhe qarkut të Fierit. Sipas regjistrimit të gjendjes civile për vitin 2016, Bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 46,507 banorësh. Aktiviteti kryesor ekonomik i Bashkisë është bujqësia, si pasojë dhe e faktit se tokat në mbulim klasifikohen si pjellore. Në një masë më të vogël është i zhvilluar dhe peshkimi në lagunën e Karavastës. Së fundmi, pikërisht falë lagunës së Karavastës ka gjetur zhvillim dhe turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje. Krahas këtij lloji specifik turizmi, Bashkia e Divjakës ka gjithashtu mundësi të mira për zhvillimin e turizmit detar dhe ekoturizmit.

Zona ku ushtrohet aktiviteti shtrihet në brendësi të zonave të sistemit rural referuar propozimit të fundit të PPV, miratuar me vendim të KKT-së Nr. 3, datë 01.08.2023 “Për korrigjimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tirane” të ndryshuar. Aktiviteti është lehtësisht i aksesueshem pasi shtrihet në rrugën “Eltion Frroku”, , që lidh zonën e aktivitetit me Tirane, Durrsin si edhe me zona të tjera në zhvillim e sipër.




Figura 3 – Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me zonat e banuara



Figura 4 – Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me hartën topografike

PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS :

OBJEKTI : STRUKTURE METALIKE E PERKOHSHME DHE NDERTIM MURI RRETHUES".
ME ZHVILLUES : Subjekti: Gurie Sula, në qyteti/fshati Cerme e Sipërme Njësia Administrative Terbuf, Bashkia Divjakë".

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË DIVJAKË

Josif GORREA

Josif Gorrea
Digitally signed by Josif Gorrea
DN: cn=Josif Gorrea, o=Kryetari i Bashkisë Divjakë

KONDIÇIONE ZHVILLIMI

SIP. E PARCELES : 4965 M²
SIP. PERIMETRI I RRETHIMIT : 432 M
SIP. STRUKTURËS METALIKE : 240 M²
LARTESIA E OBJEKTIT NGA KUOTA + 0.00 DERI NE ULLUKU: 4 M
LARTESIA E OBJEKTIT NGA KUOTA + 0.00 DERI NE KULLMIN E CATIS: 4.5 M
NUMRI I KATEVE MBI TOKE : 1
NUMRI I KATEVE NEN TOKE : 0
KOEËICIENTI I SHFRYZEZIMIT TE TERRITORIT EKZISTUES : "Sipas gjendjes ekzistuese"
INTESITETI I NDERTIMIT EKZISTUES : "Sipas gjendjes ekzistuese"


DISTANCAT NGA KUFIRI I PRONËS :

VERI: 120.3m dhe 118.9m NGA KUFIRI PRONËS
LINDJA: 3.74 m dhe 3.49 m NGA KUFIRI PRONËS
JUGU: 40.07 m dhe 40.98 m NGA KUFIRI PRONËS
PERËNDIMI: 14.37 m dhe 14.10 m NGA KUFIRI PRONËS

DISTANCAT NGA NDËRTESA ME E AFERT :


VERI: SKA m NGA NDËRTESA ME E AFERT
JUGU: SKA m NGA NDËRTESA ME E AFERT
LINDJE: SKA m NGA NDËRTESA ME E AFERT
PERËNDIMI: SKA m NGA NDËRTESA ME E AFERT

SHKALLA 1:500



SKEMA E VENDOSJES SE ZONES SE ZHVILLIMIT

SHKALLA 1:1250



POZICIONI KADASTRAL SHKALLA 1:2500

Zona Kadastrale Nr. 1381 Nr.pasurise.207/17;36



OBJEKTI "STRUKTURE METALIKE E PERKOHSHME DHE NDERTIM MURI RRETHUES"	
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT	Ardit Janko Digitally signed by Ardit Janko DN: cn=Ardit Janko, o=Kryetari i Bashkisë Divjakë
PROJEKTUES	Ark. Dritan Koci I.E. Nr. A.1899 Digitally signed by Dritan Koci DN: cn=Dritan Koci, o=Kryetari i Bashkisë Divjakë
ZHVILLUES	Subjekti: Gurie Sula

Sipërfaqja totale e përgjithshme e pronave të marra me qera ku do të ushtrohet aktiviteti është 4300 m² dhe ndodhet në pronësi private, me të cilën shoqëria ka nënshkruar kontratë qeraje para noterit për përdorimin e kësaj sipërfaqeje në funksion të aktivitetit të tij të tregëtarë.

Tabela 1: Koordinatat e zones se ushtrimit te aktivitetit

Koordinatat e Instalimit Sistemin Gauss-Kruger		
Nr	X	Y
1	4384713.30	4546948.35
2	4384736.34	4546935.77
3	4384652.67	4546766.50
4	4384630.42	4546780.54

2.3 Infrastruktura e projektit

Zona e zhvillimit të aktivitetit "Instalim për prodhim betoni", shtrihet në zone fushore të pershtatshme për këto aktivitet, e cila është në afërsi me infrastrukturën ekzistuese rrugore e cila përdoret nga shumë biznese të tjera.

Sipërfaqja e siguruar nga Subjekti nëpërmjet kontratës së qerazë nënshkruar para noterit, do të jetë në funksion për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të betonit. Gjithashtu shoqëria "2S CONSTRUCTION" sh.p.k do të sigurojë edhe kontratat për bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse si "OSHEE" sha, dhe Ujësjellës Kanalizime Divjake, për lidhjen me sistemin elektrik apo sistemin e furnizimit me ujë.

Furnizimi me energji elektrike realizohet nga rrjeti ekzistues i shperndarjes dhe furnizimit me energji elektrike te zones ne pronesi te OSHEE. Gjithashtu edhe persa i perket furnizimit me uje, ai do te sigurohet nga rrjeti ekzistues i furnizimit me uje te zones. Per mirefunksionimin e aktivitetit shoqeria ka siguruar gjithe infrastrukturen e nevojshme.

Për këtë arsye zhvillimi i aktivitetit nga ana e shoqërisë do të ndihmojë zhvillimin dhe përmbushjen e nevojave kyresore duke siguruar kështu një kapacitet të mjaftueshëm përse i përket sigurimit të markave të ndryshme të betonit me cilesi te mire.

Gjithashtu pozicionimi i aktivitetit pegjate rruges Terbuf – Cerme e Siperme si edhe rruget hyrese dhe dalese krijojne lehtesira ne aksesimin e tij si per furnizimin me lende te pare (materiale inerte) dhe shperndarjen e betonit te prodhuar por edhe per automjetet e zjarrfikses ne rast te aksidenteve te mundeshme si renia e zjarrit apo ambulancave ne rastet e aksidenteve me pasoje ne shendetin e punonjesve.

Zona e perzgjedhur per ushtrimin e ketij aktiviteti eshte e pershtatshme per kete lloj aktiviteti duke patur parasysh perparesit si:

- Furnizimi me uje;
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtesi ne aksesim nga automjetet (autobetonieret, kamionat, zjarrfikset dhe ambulancat)

Sheshi ku do zhvilohet aktiviteti në fjale ndodhet ne brendesi te prones se rregjistruar me Certificate Pronesie dhe nuk cenon pronat e tjera perreth.



Figura 5 – Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me infrastrukturen rrugore

2.4 Prodhimi i Betonit

Impianti stacionar karakterizohet nga:

- ❖ Kapaciteti i prodhimit të betonit është 50 m³/h;
- ❖ Cilësi e mirë e materialeve të ndërtimit të impiantit, e cila siguron funksionim të vazhdueshëm dhe qëndrueshmëri;
- ❖ Dizajn ergonomik që siguron saktësi të lartë në peshimin e lëndëve të para;
- ❖ Përdorimi i bazës së të dhënave për llogaritjen e "dozimit të materialeve";
- ❖ Aplikim elektronik për llogaritjen e lagështisë së agregateve me devijimin automatik dhe luhatjen e rërës dhe ujit;
- ❖ Aftësia për të korrigjuar çdo mosfunksionim në hapin e mëparshëm të procesit të prodhimit, për sa kohë që procesi është në fazën e dozimit dhe ngarkimit të materialeve inerte;
- ❖ Homogjenizimi më i mirë i betonit në mikser për të siguruar cilësi dhe standard të lartë, i cili pason lëvizjen e përzierjes pa centrifugale.
- ❖ Impianti është plotësisht automatik;
- ❖ Impianti, në bazë të programimit, pasi vendos nga operatori kodin, cilësinë dhe sasinë e betonit, përgatit porosinë, ndalon dhe i jep sinjal shoferit për transportin;
- ❖ Ofron mundësinë e përzierjeve të aditiveve kimike në receta, me përzierje automatik të raportit çimento – aditivë kimike;
- ❖ Ndan automatikisht porosite në cikle të barabarta prodhimi, dhe për këtë arsye, rezulton në më pak sforcim për impiantin;
- ❖ Baza e të dhënave ruan të gjitha funksionet në kujtesën e kompjuterit dhe printon statistikën në lidhje me: konsumin e lëndëve të para, cilësitë e prodhuara, sasinë e prodhuara, prodhimi i betonit në çdo vend ose njësi të kantierit;

Këto karakteristika janë në dispozicion të personit përgjegjës të impiantit për organizimin dhe mbikëqyrjen më të mirë të kantierit. Këto karakteristika, së bashku me sigurinë që ofrohet në cilësinë e betonit kontribuojnë në zhvillimin racional dhe arritjen e konstruksioneve më të lira të betonit për impiantin.

Njesite përbërëse të impiantit dhe karakteristikat teknike përkatëse

Impianti i prodhimit të betonit përbëhet nga këto njësi kryesore:

1- Njësia e ruajtjes së agregatit;

2- Njësia e transportit të lëndëve të para;

3- Njësia e përzierjes;

4- Njësia e ruajtjes së çimentos / sillosat e çimentos (2 cope)

5- Njësia e funksionimit elektronik;

6- Njësia e furnizimit me ujë;

7- Njësia e dozimit të aditiveve;

8- Njësia e grumbullimit dhe riciklimit të ujit;

1- Njësia e ruajtjes së agregatit.

- ❖ **Hinkë e magazinimit të agregatit** me katër (4) dhoma me kapacitet të përgjithshëm 65 m³;
- ❖ Një vibrator elektrik me masë të rregullueshme është montuar në çdo ndarje të materialeve inerte (parashikim për dy (2) dhoma) për të përmirësuar rrjedhën e materialit inert.
- ❖ Sistemi i peshimit të agregatit me kapacitet 1.500,00 Kg i montuar nën njësinë e magazinimit, me anë të katër (4) qelizave të ngarkesës.
- ❖ Një (1) shirit transportues horizontal. Tamburi i drejtimit me gomë të mbuluar për të shmangur rrëshqitjen.
- ❖ Rrjetë mbrojtëse e galvanizuar për mbrojtjen e njësisë së monitorimit të impiantit.
- ❖ Çelësit të sigurisë për ndalimin emergjent. Litar teli rreth rripit transportues.
- ❖ Kompresor ajri me piston tek.
- ❖ Të gjitha kabllot janë të tipit industrial , ngjyre gri dhe fleksibël (përthyhen sipas gjatësisë ku shtrihen por pa u këputur);

2- Njësitë e transportit të lëndëve të para

- ❖ Rrip transportues kryesor për transferimin e agregateve të peshuara në mikserp;
- ❖ Tamburi i drejtimit me gomë të mbuluar për të shmangur rrëshqitjen
- ❖ Vihet në funksion ose drejtohet nga dy (2) elektromotor 22-30 Kw dhe dy (2) kambio TA 50- 50.
- ❖ Shiriti ka një kabllo sigurie përgjatë gjithë gjatësisë së rripit të ekspozuar ndaj kontaktit aksidental, si dhe për ta lejuar atë të ndalojë në kohë në rast rreziku. Kabllo e sigurisë dhe rrjeti mbrojtës janë vendosur në një lartësinë të arritshme nga njeriu për ndërhyrje të shpejtë dhe ndalimin e menjëhershëm të impiantit në rast emergjente.
- ❖ Mbulesa mbrojtëse e vendosur në bateri dhe goma anësore përgjatë rripit.
- ❖ Mbulesa metalike nga ana e sipërme në të gjithë gjatësinë e rripit transportues.
- ❖ Mbulesa anësore e shiritit të lëvizshëm (qe mund të zëvendësohet në rast dëmtimi) që mban anët për të shmangur rënien e materialit majtas dhe djathtas.
- ❖ Katër (4) stacione qendrore për lehtësimin e drejtimit të rripit.
- ❖ Pajisje e adaptueshme për pastrim optimal të shiritit/transportierit.
- ❖ Lugë e rregullueshme e hyrjes dhe daljes së materialit.

3- Njësia e përzierjes

- ❖ Mikser me bosht të dyfishtë horizontal, me rendiment 3 m³ betoni i vibruar për cikël.
- ❖ Kapacitet prodhimi 120 m³/h, i cili garanton prodhim të qëndrueshëm të betonit me devijim standard të ulët.
- ❖ Një (1) dalje shkarkimi të reduktuar. Dalja e shkarkimit funksionon në mënyrë hidraulike me tre (3) ndërprerës limit.
- ❖ Grykë ekscentrike e bërë nga fletë çeliku për shkarkimin e betonit dhe një tub gome e bute e cila shërben për të bërë sakt shkarkimin në autobetoniere edhe në rastet kur autobetonierja nuk është pozicionuar fiks poshtë grykës së shkarkimit. Përfshihet vibrator me bazë metalike.
- ❖ Dy (2) motorë përzierës 55 Kw secili me temperaturë pune brenda klasës F, shkalla e mbrojtjes IP 55.
- ❖ Motori i paketës hidraulike 2,2 Kw me temperaturë funksionimi brenda klasës F, shkalla e mbrojtjes IP 55. Përfshihet pompë manuale me akumulim të fuqisë hidraulike.

- ❖ Sistemi i lubrifikimit automatik të vulave.
- ❖ Sistemi automatik i pastrimit të mikserit.
- ❖ Ka dy (2) kapëse të mëdha në kapakun e mikserit.
- ❖ Armatura, krahu dhe lopata janë të montuara me bulona për zëvendësim të lehtë.
- ❖ Dy (2) ballkone (platforma) metalike majtas dhe djathtas për mirëmbajtjen dhe pastrimin më të lehtë.
- ❖ Një (1) sistem peshimi të çimentos me precizion të lartë me kapacitet ngarkese 2000 kg. Vende fikse për vendosjen e peshave prototip për kalibrim, i vendosur në tre (3) qeliza ngarkese të projektuara.
- ❖ Një (1) sistem peshimi uji me precizion të lartë me kapacitet ngarkese 1000 lit.
- ❖ Një (1) pompë uji për ngarkimin/pompimin e sasisë së ujit.
- ❖ Një (1) sistem peshimi aditiv me precizion të lartë INOX me kapacitet ngarkese 50-100 lit në një (1) qelizë ngarkese. Përfshihen pompa dhe gypa për dy aditivë.
- ❖ Ruajtja paraprake e agregateve të peshuara me mbulesë metalike dhe perde PVC.
- ❖ Një (1) filtër para-magazinimi me turbinë thithëse.

4- Njësitë e ruajtjes së çimentos / sillosat e çimentos

Sillosat e çimentos janë të pajisura me themele / plinta të përshtatshme. Themelet ose plintat janë të nevojshme pasi shmangin shembjen ose përmbysje të sillosit nga kushtet atmosferike apo faktor të tjerë.

Per këte arsye është bere edhe nje raport teknik i llogaritjes nga një inxhinier i regjistruar, i cili merr parasysh sizmicitetin e zonës. Për të gjitha silloset kërkesa e detyrueshme është të mos hyni në brendësi, përveç në raste shumë të jashtëzakonshme dhe me të gjitha masat paraprake.

Persa i perket montimit te impiantit te betonit jane ndjekur hapat sipas projektit teknik duke bere instalimin dhe fiksimin e komponenteve te impiantit vec e vec si edhe lidhjen ndermjet tyre qe te funksionojë si nje i tere.

- ❖ Dy (2) sillosa monolite çimentoje 75 m³ secila me nga një shkallë sigurie, dy (2) ballkone/platforma sigurie, një (1) platform kalimi dhe gyp depozitimi D114.
- ❖ Dy (2) filtra për të montuara në sillosat e çimentos.
- ❖ Dy (2) valvola presioni.
- ❖ Treguesi/indikatore me katër (4) nivele për max dhe min.
- ❖ Dy (2) alarm me dritë të lidhur me indikatorin e nivelit maksimal.

5- Njësia e funksionimit elektronik

- ❖ Bord/panel elektrik i vendosur në një tastierë metalike që plotëson të gjitha Specifikimet e Sigurisë Evropiane (IP 54), me një ndërprerës të përgjithshëm ndalues dhe të gjitha reletë e fuqisë për funksionimin e impiantit. Ai përfshin gjithashtu të gjitha lidhjet e lidhjes me motorët, siç janë telat e komunikimit të Sistemit, Pajisje të tilla si peshore dhe matës lagështie.
- ❖ Programi i funksionimit kompjuterik automatik, kontrollues, ekran dhe printer lazer, për saktësinë e menaxhimit të agregateve, çimentos, aditivëve dhe ujit.
- ❖ Amperometri i instaluar në panelin e kontrollit. Operatori ka avantazhin të shohë amperin e mikserit në kohë reale në ekranin e kompjuterit të tij.
- ❖ Manual dhe udhëzues kompjuterik për të gjitha njësitë mekanike, elektrike dhe elektronike të impiantit të betonit.

6- Njesia edozomit te ujit dhe njesia e dozimit te aditivit sikure edhe njesite e dozimit te cimentos jane pjese e njesise se perzierjes se mase se betonit;


7- Impianti është i pajisur me nje depozite uji me kapacitet 20 m3 e cila është e lidhur me njeisne e perzierjes nepermjet tubave dhe nje sitemi pompimi dhe dozimi.


8- Njesia e grumbullimit dhe riciklimit te ujit;

Njesia e grumbullimit dhe riciklimit/riperdorimit te ujit është nje njesi e cila bene te mundur riciklimin/riperdorimin e ujrave lares te autobetoniereve dhe ujrave lares te mikesrit te impiantit. Kjo njesi, ndryshe nga vaskat tradicionale te dekantimit, bene te mundur ndarjen e inerteve nga uji qe ka permbajtje te cimentos dhe aditiveve.

Bashkengjitur skica te impiantit te prodhimit te betonit.

View A-A





Lendet e para dhe materialet ndihmese, materiale te tjera dhe energjia e perdorur ose e gjeneruar ne impiant/ instalim.

Lendet e para qe perdoren ne instalim janë:

- **Cimento;**
- **Materiale inerte (rere, zhavorr, cakull, etj);**
- **Uji;**
- **Aditive;**

Persa i përket lendeve te para si çimento, materiale inerte dhe aditivë, subjekti furnizohet nga operatore te licensuar për tregetimin e tyre.

Materialet inerte vijnë me kamion te cilët janë me sistem vetshkarkimi. Materialet inerte shkakrohen dhe ruhen te veçuara sipas llojit dhe fraksionit te grimces. Rera magazinohet e veçuar nga zhavorri. Gjithashtu edhe zhavorret qe kane fraksione te ndryshme te grimcave ruhen te veçuara nga njeri-tjetri pasi perdoren për marka te ndryshme te prodhimit te betoni. Materialet inerte magazinohen ne vende te pershtatshme te shtruara me beton dhe te rrethuara nga 3 ane me mure me blloqe. Kjo bene te mundur qe materialet inerte te magazinohen sipas llojit dhe madhesis se grimces duke mos u perzier me njeri-tjetere. Magazinimi i inerteve behet afer Hinkes se ngarkimit te impiantit.

Cimento pasi vjen me automjete te tipit autobot shkarkohet dhe magazinohet ne sillosa pjese te impiantit te betonit. Cimento nuk vjen e paketuar por vejen çimento refuxho. Cimento ruhet ne 2 sillosa te izoluar dhe te pajisur me filtra per kapjen e pluhurit te cimentos gjate fazes se dozimit te saje ne impaint. Pluhuri rikthehes serisht ne sillos.

Aditivi gjithashtu blihet nga subjekte te licensuara dhe ruhet ne depozita plastike me kapacitet 1 m3. Këto lloje depozitash janë për përdorim afatgjate dhe janë reziztente ndaj koorozionit te agjenteve atmosferike apo edhe vete vetive qe kane aditivetet. Për kete arsye këto depozita sa here qe mbaron sasia e aditivit rimbushen serisht nga operatore te licensuar për tregetimin e tyre.

Persa i përket sigurimit te ujit qe nevojitet për procesin e prodhimit te betonit, brenda sipërfaqes se marre me qera nga subjekti, ndodhet ne aferi te prones linja e funizimit me uje te zones i cili do te funizoje edhe pronen ne studim. Investitori do te perdore edhe depozita uji te cilat do te jene te instaluara brenda siperfaqes se prones te cilat do te perdoren ne rast te nderprerjes se linjes se ujit qe te mos ndalet puna ne kantier dhe do te funizohen me autobot uji ne raste te vecanta te nevojshme per kete projekt.

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren gjate fazes se funksionimit te ketij projekti janë:

- 1-Karburant, tip naftë;**
- 2- Energjia elektrike;**
- 3- Uji**

Karburanti, tip naftë do të përdoret në mjetet e ngarkimit dhe transportit te lendeve te para qe futen ne proces te cilat sigurohet nga tregu i brendshëm dhe per transportin e produkteve qe prodhohen ne kete instalim. Karburanti sigurohet nga operatore te licensuar pe tregetimin e tij dhe furnizimi kryhet ne stacionet e furnizimit te automjeteve me karburant.

Energjia elektrike sherben per te vene ne pune impiantin e prodhimit te betonit, ndricim dhe per zyrat.

Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti ekzistues I shperndarjes dhe furnizimit me energji elektrike te zones.

Produkti i prodhuar, beton i markave te ndryshme nëpërmjet autobetonieres

transportohet për ne destinacionin e përdorimit të tij.

Uji do të sigurohet nga linja e ujësjes së funizon me ujë të gjithë zonën dhe në mungesë të tij do të bëhet funizimi me ujë nëpërmjet një autoboti uji i cili do të funizojë depozitën e ujit në kantier.

Prodhimi i betonit

Betoni është një masë e përbërë nga material inertë të thata (rërë, granil), uji, cimento dhe aditive të ndryshme që ndihmojnë procesin e tharjes e të ngjirjes së betonit.

Kjo përzierje është një material natyror dhe i riciklueshëm dhe është i përdorshëm në një gamë të gjërë në fushën e ndërtimit, mund të përdoret në bordurat e rrugëve, pistave të ndryshme, shesheve dhe fushave sportive, vepra arti të ndryshme si ura, mbikalime dhe nenkalime, kolona mbajtëse, ndertesa banimi dhe shërbimi etj.

Materialët inertë që përdoren për prodhimin e betonit sipas klasave të ndryshme janë të cilësive të larta dhe konform kushteve të cilësive për këto produkte. Inerti që përdoret është i lartë dhe sigurohet nga subjektet e licensuara të cilat specifikisht meren me produkte të cilat janë në funksion të prodhimit të betonit (inertë, granular etj).

Për prodhimin e 1 m³ betoni nevojiten 1.3 m³ inertë (në raport 50% rërë e lartë dhe 50% inertë të fraksioneve të ndryshme), nevojitet 250-400 kg cimento (masa e cimentos është në varesi të markës së betonit që kërkohet të prodhohet), si dhe ujë në sasi dhe varesi të përdorimit të betonit, pasi për kullonat, themelet, soletat masa e betonit kërkohet e ndryshme në aspektin e hollë, mesatare apo masë më e thatë, ndërsa aditiv sipas rastit dhe nevojës së përdorimit (në varesi të temperaturave nën zero grade).

Nëpërmjet programimit kompjuterik duke përcaktuar markën e betonit, sasitë e nevojshme të prodhimit e cila realizohen vetë hedhjen e lëndës së parë, përzierjen dhe në mënyrë automatike realizohet prodhimi i betonit. Direkt nga fabrika nëpërmjet transportierëve, betoni i përgatitur hidhet në autobetoniere.

Koshat e depozitimit të agregatëve, të ndarë në pjesë, me porta ngarkimi me operim elektro pneumatik, me vibrator elektrik në pjesën e rërës për të lejuar rrjedhje më të mirë të materialit.

Linja e prodhimit të betonit është teknologji e standarteve europiane.

Materiali inertë depozitohet në një pistë e cila është e shtruar me beton dhe të ndara në varësi të materialit inertë dhe të madhësisë së grimcës. Materiali inertë fillimisht sipas madhësisë së grimcës hidhet në hinkën/bunkierin, në dhomat përkatëse sipas llojit të materialit inertë. Hedhja në hinkën/bunkierin, në dhomat përkatëse, kryhet me mjetet tip fadrome në dimensione të ndryshme rërë, granil të dimensioneve të ndryshme (lenda e parë sigurohet nga subjekte të licensuara për tregtimin e materialeve inertë, cimento, aditive etj). Pas hedhjes hinkën/bunkierin materialin inertë nëpërmjet shiritit transportues kalon në mikserin e impiantit. Procesi teknologjik vazhdon me peshimin e materialit inertë për realizimin e markës së kërkuar të betonit dhe nëpërmjet një shiriti transportues kalon në mikserin e impiantit. Në të njëjtën kohë që peshohet materialin inertë në peshorë, në peshorë tjetër peshohet cimento e cila vjen nga silloset e çimentos njëkohësisht bëhet edhe pompimi i ujit dhe aditiveve në sasinë përkatëse sipas masës së kërkuar të betonit. Linja e prodhimit të betonit ka 2 sillos me kapacitet 75 m³ secili. Silloset janë të mbyllur në mënyrë hermetike. Në linjë është instaluar filtri i pluhurave të cimentos në mënyrë që pluhuri të mos dalë

ne atmosfere.

Lloji i impiantit është i tillë që komandohet nepermjet njesise qendore, ku bëhet edhe programimi i sasisë së lendeve të para që do të marrin në përqindje të caktuar, për prodhimin e betonit. Impianti është i lidhur me depozitën e ujit, me depozitën e solventeve, reren e cila merret në mënyrë automatike nepermjet njesisë së parangarkimit ku qëndron lenda e parë dhe hidhet në kazanin e përzierjes.

Si pjesë integrale e impiantit të betonit është edhe njësia e grumbullimit dhe riciklimit/riperdorimit të ujrave lares që vijne nga larja dhe pastrimi i autobetonierëve dhe mikserit të impiantit.

Uji për prodhimin e betonit vijne nga dy depozita,

- 1- Depozita e ujit të freskët,
- 2- Vaska e ujrave që riperdoren (ujrat lares të impiantit dhe autobetonierëve);

Sipas rastit nepermjet panelit të kontrollit aktivizohen pompat për qarkullimin e ujit qofte nga depozita e ujit të freskët apo nga vaska e ujrave lares.

Njësia e grumbullimit dhe riciklimit/riperdorimit të ujrave

Njësia e grumbullimit dhe riciklimit/riperdorimit të ujit është një njësi e cila bën të mundur riciklimin/riperdorimin e ujrave lares të autobetonierëve dhe ujrave lares të mikserit të impiantit.

Njësia e grumbullimit dhe riciklimit/riperdorimit të ujrave përbehet nga:

- 1- Struktura betoni për larjen e autobetonierëve;
- 2- Kolona uji për larjen e autobetonierëve;
- 3- Struktura/depozite/tank celiku me base të sipërme trapezoide dhe base fundore në formën e hinkës;
- 4- Struktura betoni për materialet inerte të ndara nga masa ujore;
- 5- Vaske betoni e pajisur me perzieres për ruajtjen e ujrave lares;
- 6- Shnegu për ndarjen e materialit inert;
- 7- Pompa të qarkullimit të ujrave që riperdoren;
- 8- Linja e qarkullimit të ujrave;

Parimi i funksionimit të njesise së grumbullimit dhe riciklimit/riperdorimit të ujrave

Pas zbrazjes së mikserit të impiantit dhe pas përfundimit të prodhimit të betonit sipas kërkës, në dhomen e mikserit injektohet uji i cili shërben për larjen e ketij të fundit. Ujrat lares të mikserit të impiantit orinetohen për në depozitën prej celiku me base të sipërme trapezoide dhe base fundore në formën e hinkës.

Përsa i përket autobetonierëve pozicionohen në strukturën prej betoni të ndërtuar këtu qëllim. Pas pozicionimit të autobetonierëve, nepermjet kolonave të ujit injektohet uji në depozitën e autobetonierëve dhe në pjesën e jashtme të depozitës ku bëhet shkakrimi i betonit. Ujrat lares të autobetonierëve shkarkohen në depozitën prej celiku me base të sipërme trapezoide dhe base fundore në formën e hinkës.

Pra të gjithë rrymat e ujrave lares të cilët kanë përmbajtje të materialeve inerte, cemento aditive

shkarkohen ne depoziten prej celiku me base te siperme trapezoide dhe base fundore ne formen e hinkes.

Ne fund te tankut prej celiku, ne fund te pjese se poshte ne formen e hinkes instalohet shnegu. Materialet inerte duke qene te rende precipitohen shpejt ne ne pjesen fundore te tankut ne formen e hinkes ku ka kontakt te drejtperdrejte me spiralet e shnegut.

Me ane te shnegut, rrotullimit te spiraleve behet e mundur kapja dhe largimi i materialit inert nga tanku prej celiku dhe derdhen ne strukturen prej betoni. Nga ketu nepermjet fadromes, materiali inert i pastruar ngarkohet serisht ne bunkierin/hinken e impiantit. Ne varesi te madhesis se grimces se ketij materiali inert percaktohet edhe dhoma e bunkierit/hinkes ku do te hidhet materiali inert.

Uji qe ka ngelur ne tankun prej celiku nepermjet nje sistemi pompimi orientohet drejt vaskes se betonit.

Kapaciteti i vaskes prej betoni është mese i mjaftueshem për te perballuar ujrata lares te autobetoniereve apo mikserit te impiantit.

Vaska e betonit është e pajisur me dy perzieresa te cilet bejtte te mundur perzjerjen e ujrave ne menyre te vazhdueshme me qellim qe masa ujore kur te riperdoret te kete nje mase homogjene ku sasia e ujit te kete te njejten perqindje cimento dhe aditive per njesi.

Ujrat nga vaska e betonit pasi jane homogjenizuar me dy perzierat, nepermejt sistemit te pompimit dhe riqarkullimit te ujit, shkojne ne mikserin e impiantit

Ne kete menyre eliminojme shkarkimin e ujrave ne mjedis dhe gjenerimin e mbetjeve nga procesi i prodhimit te betonit.




Figura 7 – Paraqitje skematike e njesise se grumbullimit dhe riciklimit/riperdorimit te ujrave

Mbetje te përziera urbane

Mbetjet e përziera urbane gjenerohen nga aktiviteti njerëzor i punonjësve. Mbetjet e përziera urbane

grumbullohen ne koshat e mbetjeve urbane te vendosur nga subjekti ne ambientet e aktivitetit te cilët me pas shkarkohen ne kontenieret e përbashkët te mbetjeve urbane te vendosur nga pushteti vendor Bashkia Divjake ne afërsi te zonës se aktivitetit.

Nga procesi i prodhimit te betonit nuk kemi gjenerim te mbetjeve te tjera perves mbetjeve te deklaruar me siper. Sic e kemi permendur lendet e para nuk vijne ta ambalazhuar dhe paketuara ne mase te vogel por blihen dhe magazinohen ne mase te madhe sipas kushte dhe vetive fizike qe kane lendete e para ku, cimento vjen rifuxho dhe magazinohet ne sillos, aditivi po ashtu vjen me depozita plastike me kapacitet 1000 litra (1 m³), depozita qe riperdoren për kohe te gjata, materialet inerte depozitohen ne nje siperfaqe te shtruar me beton te vecuara nga njera-tjetra sipas fraksionit te grimces. Ne kete menyre nuk kemi mbetje nga ambalazhet.

3. Pershkrimi i mjedisit në zonën e projektit

Në këtë paragraf do të jepen konsiderata të përgjithshme në lidhje me karakteristikat fizike, biologjike dhe socio-ekonomike të mjedisit ku propozohet të zhvillohet projekti.

3.1 Pozicioni Gjeografik dhe morfologjia

Bashkia e Divjakës shtrihet në Shqipërinë e Mesme dhe mbulon një sipërfaqe prej 309,58 km². Bashkia e re e Divjakës përbëhet nga pesë njësi administrative: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradishtë dhe Remas. Në vijim, Bashkia ka nën administrimin e saj qytetin e Divjakës dhe 39 fshatra, të cilat janë pjesë e rrethit të Lushnjës dhe qarkut të Fierit. Sipas regjistrit të gjendjes civile për vitin 2016, Bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 46,507 banorësh. Aktiviteti kryesor ekonomik i Bashkisë është bujqësia, si pasojë dhe e faktit se tokat në mbulim klasifikohen si pjellore. Në një masë më të vogël është i zhvilluar dhe peshkimi në lagunën e Karavastasë. Së fundmi, pikërisht falë lagunës së Karavastasë ka gjetur zhvillim dhe turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje. Krahas këtij lloji specifik turizmi, Bashkia e Divjakës ka gjithashtu mundësi të mira për zhvillimin e turizmit detar dhe ekoturizmit.




Figura 8 – Harta administrative e Bashkisë Divjake

BASHKIA	QENDRA E BASHKISË	NJËSITË ADMINISTRATIVE	QYTETET DHE FSHATRAT RESPEKTIVE
Divjakë	Qyteti Divjake	Divjake	Qyteti Divjake Fshatrat; Mize, Xenge, Germenj i Madh, Germenj i Vogel, Hallvaxhias, Bregas, Dushk Cam, Zharnec, Bishtcukas
		Terbuf	Fshatrat; Cerme Shkumbin, Cerme Proshke, Sulzotaj, Cerme e Siperme, Terbuf, Shenepremte, Cerme Pasha
		Grabjan	Fshatrat; Grabjan, Stravec, Ferras
		Gradishte	Fshatrat; Kemishtaj, Mertish, Gorica, Sopes, Fier Seman, Gradishte, Gungas, Spolet, Babunje
		Remas	Fshatrat; Remas, Mucias, Karavasta Fshat, Gure, Kryekuq, Kamenice, Karavasta e re, Adriatik

Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Divjakës. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezulton një popullsi 53.372 banorësh. Territori i bashkisë së re është 309.58 km² dhe me densitet popullsie 172.40 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra.

Bashkia e Divjakës përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Rremas. Bashkia e re ndodhet në një zonë tërësisht rurale dhe pjellore, ndërkohë që pjesë e territorit të kësaj bashkie është edhe parku kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës. Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore. Divjaka ka perspektivë të mirë për zhvillimin e turizmit detar si dhe ekoturizmit. Gjatë viteve të fundit këtu është shfaqur turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje në lagunën e Karavastasë. Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.

3.2 PROFILI I BASHKISË

Zona Gjeografike: Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë së re do të jetë qyteti i Divjakës, i shpallur qytet me vendim qeverie në vitin 1996.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezulton një popullsi 54.368 vetë. Territori i bashkisë së re është 309.58 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 110 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrin civil densiteti është 172.40 banorë/km².

PROFILI DEMOGRAFIK						
Sipërfaqe (km ²)	Numri i Njërive Administrative	Numri i Qyteteve	Numri i Fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrin Civil 2016	Popullsia sipas Census 2011
309.58	5	1	39	14151	54368	34254

Të dhëna të tjera: Bashkia e Divjakës është nga të paktat bashki të krijuara nga reforma administrative dhe

territoriale e cila përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Rremas është e dobët.

Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore. Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.

Gjithashtu, Divjaka ka një jetë artistike dhe kulturore që shumë qytete do ia kishin zili. Këtu funksionon më së miri grupi artistik i qytetit, me djem dhe vajza valltarë, të cilët përfaqësojnë Divjakën në aktivitete të ndryshme kulturore.

3.3 Mjedisi Socio-Ekonomik

Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore. Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.

3.4 Mjedisi Fizik

3.5 Gjeomorfologjia, Gjeologjia


